

Fjala përshëndetëse e Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, zonja Fiona Papajorgji, në audiencën me Presidentin e Republikës Italiane, Shkëlqesinë e Tij, Zotin Sergio Mattarella,

I nderuar zoti President i Republikës Italiane, Shkëlqesia Juaj Sergio Mattarella,

I nderuar zoti Cremades dhe anëtarë të delegacionit të World Jurist Association dhe World Law Foundation

Të nderuar kolegë dhe të pranishëm të tjerë,

Është një nder i jashtëzakonshëm dhe një privilegj i lartë institucional që, në cilësinë e Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe Kryetares së Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Europiane, të jem pjesë e këtij takimi së bashku me kolegët tanë të nderuar të Gjykatës së Lartë e Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësuesit e delegacionit të World Jurist Association dhe World Law Foundation.

Ky takim mbart një simbolikë të veçantë, pasi ju takojme ju si Kreun e Shtetit të një vendi mik dhe aleat strategjik të Shqipërisë, por edhe si një jurist të shquar dhe ish-gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese Italiane.

Kjo e bën dialogun tonë edhe më të natyrshëm dhe më të afërt, të mbështetur në një përkushtim të përbashkët ndaj mbrojtjes së Kushtetutës, të drejtave themelore dhe parimeve të demokracisë kushtetuese. Më lejoni, me këtë rast, t'ju përcjell edhe përshëndetjet më të ngrohta të trupës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Shqipëria dhe Italia kanë lidhje të thella që shkojnë përtej afërsisë gjeografike. Dy vendet tona i bashkon historia, kultura, marrëdhëniet institucionale dhe, mbi të gjitha, besimi i përbashkët se projekti evropian bazohet në demokraci, sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave themelore.

Në planin kushtetues, kjo afërsi reflektohet në ngjashmëritë e traditave tona juridike, në bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet dy Gjykatave Kushtetuese dhe në referimin e vazhdueshëm që jurisprudenca jonë i bën përvojës dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese Italiane.

Rrugëtimi i Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian nuk konsiston vetëm në zbatimin e *acquis communautaire*. Është gjithashtu një udhëtim krahasimi dhe përballjesh midis përvojave ligjore, kulturave kushtetuese dhe modeleve për mbrojtjen e të drejtave themelore. Në kuadër të këtij procesi, kontributi i praktikës gjyqësore kushtetuese dhe i doktrinës juridike luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm.

Gjatë vitit 2027, Shqipëria do të shndërrohet, për disa ditë, në një pikë takimi për komunitetin ndërkombëtar juridik dhe një hapësirë dialogu, shkëmbimi dhe bashkëpunimi.

Kjo do të ndodhë jo vetëm në kuadër të Kryesimit të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, por edhe për faktin se angazhimi ndaj vlerave të demokracisë dhe shtetit të së drejtës do të marrë një dimension edhe më të gjerë me organizimin e *World Law Congress 2027* në Tiranë.

E krijuar që prej vitit 1963, me një ide që mbetet po aq aktuale edhe sot: *Një botë e qeverisur nga ligji dhe jo nga forca*, *World Jurist Association* ka organizuar për më shumë se gjashtë dekada Kongrese Botërore të Ligjit duke bashkuar krerë shtetesh, kryetarë të gjykatave kushtetuese dhe supreme, gjyqtarë dhe akademikë, si dhe përfaqësues nga shoqëria civile nga e gjithë bota.

Nën drejtimin e zotit Javier Cremades, që nga 2019, Kongresi është rritur dhe kthyer në një nga organizimet më me influencë në botë dhe me një shkallë të lartë të pjesëmarrjes së komunitetit juridik ndërkombëtar.

Të marra së bashku, eventet e organizuara nga WJA në harkun kohor 2019-2025 kanë mbledhur së bashku rreth 5500 juristë nga 85 kombësi të ndryshme : vetëm Kongresi i vitit 2023, i zhvilluar në New York, kishte mbi 350 folës / 50 panele dhe ceremonia e mbylljes së tij u bë në Hollin e selisë së Kombeve të Bashkuara;

Kongresi i ardhshëm do të zhvillohet në Tiranë, në datat 3, 4 dhe 5 maj 2027, me temën “*On the Rule of Law, Shaping the New Generations*”.

Duke përfituar nga rasti, kam nderin dhe kënaqësinë t’Ju përcjell zoti President, edhe në emër të kolegëve, dëshirën t’Ju mirëpresim në Tiranë, në punimet e këtij Kongresi. Prania Juaj dhe e përfaqësuesve të komunitetit juridik italian është nder dhe vlerë e shtuar e çmuar për eventin.

Kongresi i vitit 2027 zhvillohet gjithashtu në një moment me rëndësi të veçantë në rrugëtimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin European, një proces që kërkon vijimësi, besim dhe mbështetjen e partnerëve tanë ndërkombëtarë. Në këtë kuadër, mbështetja e vazhdueshme e Italisë, si edhe angazhimi Juaj personal, Zoti President, kanë pasur dhe vijnë të kenë një vlerë të veçantë për vendin tonë. Për këtë mbetemi thellësisht mirënjohës.

Do të doja ta përmbyllja këtë përshëndetje të shkurtër duke ndarë edhe një reflektim personal, që për mua ka një domethënie të veçantë. Lidhja ime me Italinë është e hershme dhe e thellë, pasi pikërisht këtu kanë nisur hapat e parë të formimit tim juridik: kam pasur privilegjin të kryej studimet për drejtësi dhe më pas të zhvilloj për disa vite përvojën time profesionale. Për këtë arsye, rikthimi sot në Itali, në këtë cilësi institucionale, mbart për mua një kuptim të veçantë, si profesional ashtu edhe njerëzor.

Shkëlqesia Juaj, duke shprehur edhe një herë falënderimet tona për këtë pritje të veçantë dhe për miqësinë e qëndrueshme ndaj Shqipërisë, si dhe bindjen se afërsia mes vendeve dhe institucioneve tona do të vijojë të thellohet, në frymën e besimit të ndërsjellë dhe të përkushtimit të përbashkët ndaj demokracisë dhe sundimit të ligjit, ju urojmë shëndet dhe suksese të mëtejshme në misionin Tuaj të lartë në krye të Republikës Italiane.

Ju faleminderit për vëmendjen!